



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional

STANDARDI I PROFESIONIT

“Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit”

Spektori: BUJQËSI dhe PYLLTARI

Kodi: 6115

Data e aprovimit:

Ky standard i profesionit është zhvilluar me mbështetjen e projektit SWEI (Skilled Workforce for Economic Integration/Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik) i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i cili implementohet nga APPK (Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Ekipi i zhvillimit:

1. **Driton Berisha – Ekspert dhe koordinator i ekipit**
2. **Skender Fejzullahu – Ekspert**
3. **Fadil Milaku – Ekspert**
4. **Agron Hajdari – Ekspert (APPK)**

Ekipi verifikues:

- 1.
- 2.
- 3.

Data e aprovimit:

Valide prej:

Profesioni: “Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit”

Profesioni “Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit” do të zhvillojë tek vijuesit e trajnimeve aftësi teknike mbi gjenerimin e idesë për mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit. Standardi në veçanti fokusohet që të ndërtoj kapacitete për punëtorët dhe kultivuesit të kësaj fushe që nga identifikimi i frutave të malit, mbledhja sipas standardeve për mbledhje, ambalazhimi dhe transportimi, ruajtja, kultivimi sipas sistemit të prodhimit organik, plehërimi me plehra organike, mbrojtja me preparate të cilat janë të lejuara në prodhimtarin organike.

Përshkrimi i Profesionit

Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit bëjnë identifikimin botanik të frutave të malit, marrin masa në mbrojtjen, shëndetin dhe sigurinë në punë duke aplikuar standardet dhe rregulloret në fuqi. Bëjnë mbledhjen, kultivimin, vjeljen dhe trajtimin e pas vjeljes, kujdesen për grumbullimin sipas koncepteve bazë të ruajtjes dhe higjienës. Kryen detyra operative në kultivimin e frutave të malit sipas sistemeve të kultivimit. Kryen detyra administrative dhe biznesore si dhe bëjnë promovimin e produktit të frutave të malit.

Kompetencat e Përgjithshme

Për të arritur standardin profesional personi duhet të jetë në gjendje:

- Të identifikojnë llojet e bimëve nga të cilat duhet të marrim prodhimet
- Të dijë se cilat pjesë të bimës duhet vjelur
- Të dijë se sa përqindjen (%) e prodhimit që duhet vjelë
- Të dijë kohën më të përshtatshme për vjelje
- Të përvetësoj praktikën më të mirë të vjeljes
- Të dijë kohën e pjekjes së frutave
- Të ketë njohuri se cilat paketime duhet mi përdor të secila bimë
- Të ketë njohuri për kushtet e ruajtjes së frutave
- Të ketë njohuri se si bëhet kultivimi i këtyre bimëve
- Të ketë njohuri për sistemet e prodhimit të frutave
- Të ketë njohuri se cilat plehra mundë të përdoren në prodhimtarin organike
- Të ketë njohuri se cilat preparate mundë të përdoren në prodhimtarin organike
- Të dijë për kushtet agroekologjike që kërkojnë bimët për rritje dhe zhvillim
- Të përvetësojnë veçoritë e mjedisit të punës
- Të bëjë planifikimin e punëve

Krahas këtyre kompetencave të përgjithshme të cekura më lartë vijuesi i trajnimit duhet:

- Të kuptoj qëllimet e përdorimit të frutave
- Të kuptojë rëndësinë e kultivimit të frutave
- Të kuptoj rëndësinë e përdorimit të praktikave me të mira të kultivimit dhe vjeljes
- Të kuptoj rëndësinë e përdorimit të paketimeve adekuate dhe transportit
- Të dijë se në cilën temperaturë duhet bërë ruajtja e frutave, përqindja e lagështisë së ajrit, ajrosja
- Të kuptoj se cilat toka janë më të përshtatshme për kultivim të bimëve
- Të kuptoj se në çfarë lartësie mbidetare mund të kultivohen bimët si dhe ekspozicionin më të përshtatshëm.

STANDARDI I PROFESIONIT

“Punëtor për kultivim dhe përpunim të frutave të malit”

Nr.	Funksioni	Përshkrimi dhe funksioni
1.	Bën identifikimin botanik të frutave të malit	Kjo ka të bëjë me: Njohuritë e fituara që sigurojnë se frutat e vjelura dhe grumbulluara në natyrë janë identifikuar me saktësi nga mbledhësit-grumbulluesit që janë trajnuar për vjeljen e frutave të malit.
2.	Bën vjeljen dhe trajtimin e pasvjeljes (përpunimin) e frutave të malit sipas koncepteve bazë të ruajtjes dhe higjienës	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Me kryerjen e detyrave operative që ndërlidhen me procesin e vjeljes, pastrimin, kalibrimi, klasifikimin, tharjen, matjen, paketimin dhe etiketimin e produkteve para deponimit si dhe ruajtjes dhe transportimit të frutave të malit. Këto aktivitete mund të kryhen në mënyrë manuale (me dorë) ose në mënyrë mekanike (me vegla punë) sipas praktikave më të mira bujqësore. Pos kësaj, ky funksion përfshinë vendosjen dhe kontrollimin e kushteve të depos, mirëmbajtjen e pastërtisë, menaxhimin e mbeturinave, dhe zbatimin e standardeve për siguri dhe higjienë.
3.	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Me trajnimin, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e punëtorëve në mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit, si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtje, shëndet dhe siguri në punë dhe mbrojtje të mjedisit.
4.	Aplikon Standardet, rregulloret dhe ligjet në fuqi si dhe përfillë etikën dhe parimet në punën e tij	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Njohet me ligjet, konventat, rregulloret dhe standardet që kanë të bëjnë me mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit si dhe përfilljen e etikës dhe parimeve në punën e tij. Siguron që grumbulluesit i përmbushin rregullat nacionale dhe ndërkombëtare, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me grumbullimin, dokumentimin dhe gjurmëshmërinë e frutave të malit.
5.	Njohet me kushtet agroekologjike të kultivimit të frutave të malit	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Njohuritë e fituara për kërkesat e bimëve për kushtet agroekologjike siç janë: temperatura, lagështia, drita, lartësia mbidetare dhe toka.
6.	Kryen detyra agropomoteknike në kultivimin e frutave të malit	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Me aktivitetet që ndërlidhen me kultivimin e frutave të malit në mënyrë ekstenzive dhe intenzive sipas sistemeve standarde të kultivimit. Ky funksion përfshinë edhe aktivitete tjera, varësisht nga lloji i frutave të malit si dhe natyrës së kultivimit.
7.	Kryen detyra administrative dhe biznesore si dhe bën promovim e frutave të malit	<i>Kjo ka të bëjë me:</i> Me kryerjen e detyrave administrative dhe biznesore që janë të nevojshme për udhëheqjen e punës në një plantacion të vogël për kultivimin edhe mbledhjen e frutave të malit. Funksioni përfshinë kujdesin ndaj dokumenteve të punës, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogarive të thjeshta ekonomike; si dhe promovimin, tregtimin dhe shitjen e prodhimeve të vjelura, kultivuara dhe procesuara/përpunuara.

Funksioni 1. Bën identifikimin botanik të frutave të malit

Kjo ka të bëjë me: Njohuritë e fituara që sigurojnë se frutat e vjelura dhe grumbulluara në natyrë janë identifikuar me saktësi nga mbledhësit-grumbulluesit që janë trajnuar për vjeljen e frutave të malit.

Aktivitete kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Ndjek trajnimet profesionale në identifikimin e FM	<p>Kupton rëndësinë që ka identifikimi në natyrë i FM të egra ose të kultivuara.</p> <p>Kupton rëndësinë që ka përdorimi i katalogëve, manualeve, atlaseve për identifikim të bimëve mjekuese dhe aromatike.</p> <p>Kupton metodën makroskopike të identifikimit të FM duke përdorë shqisat.</p>	<p>Njohuri të mira që të dallon me frutat e malit që rriten si të egra.</p> <p>Njohuri të mira dhe aftësi për të përdorë atlase ose manuale që shërbejnë për determinim të FM.</p> <p>Njohuri të mira në identifikimin makroskopik të FM.</p> <p>Njohuri të mira për organet vegjetative dhe reproduktive të bimëve.</p>	<p>Posedon shkathtësi të mira për identifikimin në natyrë FM.</p> <p>Posedon shkathtësi në përdorim të manualeve, atlaseve dhe internetit për identifikim të FM.</p> <p>Shkathtësi të dallon me sy pjesët përdorshme të FM.</p> <p>Posedon shkathtësi të njoh habitatet dhe të gjejë në natyrë FM.</p>	<p>Bën zgjidhjen e literaturës për identifikim të FM.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale;</p> <p>I/e vetëdijshëm për rëndësinë që ka njohja e FM;</p> <p>I përshtatshëm për punë në zyrë dhe në terren.</p> <p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p>
Ndjek trajnimet profesionale në identifikimin e zonave të pasura me FM	<p>Kupton rëndësinë që ka identifikimi i zonave të pasura me FM.</p> <p>Arrin të dallojë dhe t'i gjejë habitatet/biotopet e pasura me FM</p>	<p>Njohuri të mira për habitatet (biotopet) si dhe zonat e përhapjes dhe rritjes së FM.</p>		

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Zyra me të gjitha pajisjet, kompjuter, qasje në internet, manuale, katalogë dhe atlase për determinim (identifikim) të FM etj.

Pos kësaj, në përputhje me kushtet e punës duhet të jenë në dispozicion edhe mjetet që nevojiten për marrjen e llojeve për identifikim në terren si: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet tjera mbrojtëse, manualët ose udhëzuesit për identifikim të frutave të malit.

Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturave që kandidati i arrin në praktik të këtyre njohurive dhe shkathtësive në identifikimin e FM.

Kërkesat e vlerësimit

Për të arritur këtë funksion, kandidati duhet të jetë në gjendje të bëjë identifikimin e saktë të FM të ndryshme sipas rregullave, të kuptojë procesin e vjeljes si dhe ruajtjen dhe higjienën personale dhe higjienën e vendin e punës.

Kandidati do të duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi praktik. Kandidati mbikëqyret gjatë punës së tij/saj sa i përket aktiviteteve në vijim: identifikimin e FM të ndryshme si dhe metodat e vjeljes procesin e vjeljes. Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturave që kandidati i arrin në praktikim të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Evidenca e performancës

Instrumentet për vlerësim: Testi me shkrim si dhe listë kontrolli për vlerësimin e punës praktike në identifikimin e frutave të malit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkuara më lart.

Funksioni 2. Bën vjeljen dhe trajtimin e pasvjeljes (përpunimin) e frutave të malit sipas koncepteve bazë të ruajtjes dhe higjienës

Kjo ka të bëj me: Me kryerjen e detyrave operative që ndërlidhen me procesin e identifikimit e frutave të malit, vjeljes, pastrimit, kalibrimit, klasifikimit, tharjen, matjen, paketimin dhe etiketimin e produkteve para deponimit si dhe ruajtjes dhe transportimit të frutave të malit. Këto aktivitete mund të kryhen në mënyrë manuale (me dorë) ose në mënyrë mekanike (me vegla punë) sipas praktikave më të mira bujqësore.

Pos kësaj, ky funksion përfshinë vendosjen dhe kontrollimin e kushteve të depos, mirëmbajtjen e pastërtisë, menaxhimin e mbeturinave, dhe zbatimin e standardeve për siguri dhe higjienë.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Bën vjeljen në kohën e duhur të frutave të malit	<p>Bën planifikimet e duhura për vjeljen e frutave të malit.</p> <p>Zgjedhë dhe ben mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe metodave më të përshtatshme për vjelje.</p> <p>Kontrollon pjekurinë e llojeve të ndryshme të frutave në raport me qëllimin përfundimtar.</p> <p>Përcakton kohën e pjekjes së frutave duke përdorur pajisjet përkatëse.</p> <p>Vjel frutat me kohën e duhur në mënyrë efikase me dorë dhe me mjete adekuate.</p>	<p>Njohuri për praktikat e mira të vjeljes dhe përpunimit.</p> <p>Njohuri për simptomat e pjekjes së frutave.</p> <p>Mënyrat më të përshtatshme për vjelje.</p> <p>Pajisjet për përcaktimin e pjekurisë.</p> <p>Njohuri rreth klasifikimit, ruajtjes dhe transportimit.</p> <p>Njeh mirë mënyrat e vjeljes së frutave në mënyrë manuale dhe në mënyrë të mekanizuar.</p> <p>Njeh mirë kriteret e klasifikimit dhe pajisjet manuale dhe mekanike për klasifikim.</p>	<p>Posedon shkathtësi të mira për planifikim dhe analizim të metodave për vjeljen e frutave, klasifikim, transportim dhe ruajtje.</p> <p>Posedon shkathtësi për përdorimin e veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Respektimi i udhëzimeve për përdorim të veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Vërejtja e problemeve në material dhe në pajisje.</p> <p>Zgjidhja e problemeve që janë të lehta për eliminim në vendin e punës.</p> <p>Aplikimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p>	<p>Bën zgjidhjen e problemeve në konsultë me kolegët.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale.</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen.</p> <p>I përshtatshëm për punë ekipore.</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur.</p> <p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike matematikore.</p>
Bën klasifikimin, pastrimin dhe deponimin e FM te vjelura	Bën kalibrimin dhe klasifikimin e frutave në baze të kriterëve të parapara.			

	<p>Bën matjen e frutave të malit.</p> <p>Paketon frutat e vjela sipas standardeve dhe karakteristikave të tyre.</p> <p>Deponon frutat në kushte adekuate që kërkohen sipas standardeve të ruajtjes dhe higjienës.</p> <p>Transporton produktet e vjela në mënyrë adekuate sipas standardeve me te larta për transport.</p> <p>Analizon kapacitetet për ruajtje dhe mënyrën e ruajtjes.</p> <p>Kontrollon aparaturat për temperatura adekuate ne depo.</p> <p>Ben përgatitjen e produkteve për tharje në tharëse artificiale.</p> <p>Vendos produktet në arka për ngrirje ne temperaturat e duhura.</p> <p>Etiketon dhe ngarkon frutat e malit për shpërndarje të mëtejme.</p>	<p>Njohuri rrethe mënyrave të tharjes dhe din ti përdor pajisjet për tharjen e frutave.</p> <p>Transportimi, paketimi dhe qëndrueshmëria e frutave në depo.</p> <p>Njohuri rreth kushteve te deponimit të frutave.</p> <p>Ka njohuri rreth kërkesave te frutave të malit për ruajtje.</p> <p>Din mi përdor pajisjet që bëjnë rregullimin e temperaturës në depo.</p> <p>Rregullat kryesore në lidhje me eliminimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ambientit.</p>	<p>Aplikimi i praktikave të mira për eliminimin e mbeturinave.</p>	<p>Shqisa të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjës dhe dëgjimit.</p>
--	---	---	--	--

Siguron kushtet bazë të ruajtjes dhe higjienës ne depo	Kontrollon nëse vendi ku behet kalibrimi, klasifikimi, paketimi dhe ruajtja është pastruar si duhet dhe nëse është në rregull. Mban pastër vendin e punës duke menaxhuar në mënyrë të sigurve mbeturinat në bazë të llojit të tyre.			
---	--	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të realizuar këtë funksion nevojiten këto asete: parcela me fruta të malit, depo për ruajtjen e FM të vjelua, frigoriferi për ruajtje me ngrirje të thellë, tharëse artificiale, arkat ose thasë për transport të FM, mjetet transportuese, si dhe veglat dhe pajisjet manuale dhe mekanike të cilat përdoren gjatë mbledhjes dhe kultivimit, kalibrim, klasifikim dhe deponim të frutave.

Pos kësaj, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët për klasifikim, paketim dhe deponim të frutave, shenjat dhe udhëzimet për shëndet, mbrojtje dhe siguri në punë.

Kriteret e vlerësimit:

Për të arritur këtë funksion, kandidati duhet të jetë në gjendje të bëjë vjeljen sipas rregullave, të kuptojë procesin e pasvjeljes si dhe ruajtjen dhe higjienën personale dhe higjienën e vendin e punës.

Kandidati do të duhej t'i nënshtrohej një vlerësimi praktik. Kandidati mbikëqyret gjatë punës së tij/saj sa i përket aktiviteteve në vijim: procesin e vjeljes, procesin e pasvjeljes apo përpunimin si dhe përgatitjen e depos sipas kushteve për ruajtje dhe higjienë. Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturave që kandidati i arrin në praktikim të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Evidenca e performances:

Evidenca do të bëhet përmes ushtrimeve praktike, demonstrimeve si dhe përmes listës së kontrollit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkuara më lart.

Funksioni 3: Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Kjo ka të bëj me: Trajnimin, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e punëtorëve në mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit, si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtje, shëndet, siguri në punë dhe mbrojtja te mjedisit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
<p>Përgatita e punëtorëve me njohuri shtese rreth sigurisë në punë përmes trajnimit dhe ushtrimeve.</p>	<p>Kupton rëndësin e sigurisë në punë gjatë mbledhjes, kultivimit dhe përpunimit të frutave malore dhe është në gjendje ti përdor manualët rreth sigurisë në punë.</p> <p>Praktikon rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë.</p> <p>Aplikon praktikat të mira të mbledhjes, kultivimit dhe përpunimit.</p> <p>Vendos shenjat për sigurinë në vendin e punës dhe përdor udhëzimet rreth higjienës dhe sigurisë në punë.</p>	<p>Njohuri e rregulloreve të sigurisë në punë.</p> <p>Njohuri e praktikave të mira higjienike dhe atyre te prodhimit.</p> <p>Njohuri rreth kërkesave të vendit të punës.</p> <p>Njihë shenjat e paralajmërimit që përdoren për siguri në punë.</p> <p>Njohuri rreth veglave dhe pajisjeve të cilat përdoren për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit.</p> <p>Njohuri me rreziqet që mundë ti ketë në punë.</p> <p>Njohuri rreth preparateve për pastrim si dhe rreth praktikave.</p> <p>Njohuri rreth procedurave në rast të dështimeve në vendin e punës.</p>	<p>Interpreton udhëzimet rreth rregulloreve të sigurisë në punë.</p> <p>Respektimi i udhëzimeve për përdorim të veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Posedon shkathtësi për përdorimin e veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Vërejtja e problemeve në material dhe në pajisje.</p> <p>Zgjidhja e problemeve që janë të lehta për eliminim në vendin e punës.</p> <p>Aplikimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p>	<p>Bën zgjidhjen e problemeve në konsultë me kolegët.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale;</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen;</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur</p> <p>Komunikativ/e.</p> <p>Aftësi për të respektuar rregullat për siguri në punë.</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike matematikore</p>

<p>Përdor pajisjet dhe preparatet e lejuara dhe të nevojshme varësisht prej vendit të punës</p>	<p>Përzgjedhë dhe përgatit veglat dhe pajisjet e punës në përputhje me aktivitetin</p> <p>Është në gjendje të përdor mjetet dhe preparatet e nevojshme që përdoren gjatë vjeljes, kultivimit dhe përpunimit të frutave malore.</p>	<p>Njohurit për përzgjedhjen dhe përdorimin e veglave të punës.</p> <p>Njohuri për përdorimin e preparateve kimike.</p>	<p>Aplikimi i praktikave të mira për eliminimin e mbeturinave.</p> <p>Aplikimi i rregullave dhe ligjeve për mbrojtën e mjedisit</p>	<p>Shqisa të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjes dhe dëgjimit</p>
<p>Aplikon rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtës së mjedisit</p>	<p>Kryen praktikatat e rekomanduara personale si dhe ato të higjienës së vendit të punës.</p> <p>Praktikon sigurinë në punë në përputhje me kërkesat e detyrave të veçanta të punës.</p> <p>Përzgjedh dhe përdorë masa të përshtatshme për siguri në punë sipas llojit të aktivitetit.</p> <p>Zbaton rregulloret në fushën e sigurisë në punë</p> <p>Mban të pastër vendin e punës duke menaxhuar në mënyrë të sigurtë mbeturinat në bazë të llojit të tyre.</p> <p>Reagon në mënyrë të duhur në rast të mos-respektimit të rregullave dhe në situata të sigurisë ndaj rreziqeve.</p>	<p>Njih dhe përdor protokolin dhe mjetet për siguri në punë</p> <p>Ka njohuri të nevojshme për mbrojtje në punë dhe mbrojtën e mjedisit</p> <p>Njih drejtë shenjat e shënimit për paralajmërim nga rreziqet konkrete</p> <p>Njohuri të mira në menaxhmin e mbeturinave</p>		

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të kryer këtë funksion burimet në vijim do të duhej të jenë në dispozicion: veglat e punës, uniforma e punës, mbathjet dhe materialet tjera mbrojtëse, udhëzues apo manuale rreth procesit të mbledhjes, kultivim dhe përpunim, udhëzues apo manuale rreth veglave dhe pajisjeve, simbole dhe instruksione sa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, pakoja e higjienës si dhe objekte dhe pajisje tjera sanitare.

Kriteret e vlerësimit:

Me qëllim të vlerësimit të njohurive të kandidatit/ kandidates sa i përket këtij funksioni do të duhet të përdorej një grup pyetjesh dhe përgjigjesh. Kandidati/ja do të duhej t'i nënshtrohej një vlerësimi teorikë -praktik në punëtori. Kandidati mbikëqyret gjatë punës së tij/ saj sa i përket aktiviteteve në vijim: kontrollimi i përshtatshmërisë së vendit të punës, përkujdesja dhe përdorimi i preparateve të ndryshme, kujdesi ndaj vendit të punës sa i përket pastërtisë dhe sigurisë, si dhe menaxhimi i mbeturinave.

Evidenca e performancës:

Instrumentet për vlerësim: Testi me shkrim si dhe listë kontrolli për vlerësimin e punës praktike

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkuara më lart.

Funksioni 4: Aplikon standardet rregulloret dhe ligjet në fuqi si dhe përfillë dhe respekton etikën dhe parimet në punën e tij

Kjo ka të bëjë me: Njoftohet me ligjet, konventat, rregulloret dhe standardet që kanë të bëjnë me mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit si dhe përfilljen e etikës dhe parimeve në punën e tij. Siguron që grumbulluesit i përmbushin rregullat nacionale dhe ndërkombëtare, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me grumbullimin, dokumentimin dhe gjurmëshmërinë e frutave të malit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Zbaton standardet rregulloret dhe ligjet në fuqi si dhe përfill etikën dhe parimet në punë.	<p>Kupton ligjet, konventat dhe rregulloret vendore dhe ndërkombëtare që duhet zbatuar gjatë vjeljes në natyrë, procesit të kultivimit dhe përpunimit të FM.</p> <p>Arrin të siguron material që ka të bëjë me manuale, atlase, rregullore dhe konventa që kanë të bëjnë me FM</p>	<p>Me saktësi din të implementoj rregulloret dhe ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me vjeljen e FM dhe ruajtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara.</p> <p>Dinë të përdorë metodat bashkëkohore të kultivimit.</p> <p>Dinë të mbaj shënime në libër gjatë procesit të vjeljes dhe përpunimit.</p>	<p>Arrin të identifikoi zonat e pasura me FM.</p> <p>Arrin të përdorë metodat e mira në mbledhje dhe kultivim.</p> <p>Arrin të nxjerrë në treg produkte të kualitetit të lartë.</p> <p>Shkathtësi për të komunikuar me email.</p> <p>Tel. me vjelës, grumbullues dhe kompani që merren me FM.</p> <p>Posedon aftësi për punë të pavarur dhe</p>	<p>Bën zgjidhjen e problemeve në konsultë me kolegët.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale.</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen.</p> <p>I përshtatshëm për punë ekipore.</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur.</p> <p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p>
Mban evidence gjate mbledhjes dhe klasifikimit te bimëve si dhe proceseve te punës.	<p>Kupton procesin e dokumentimit, mbajtjes se shënimeve që është pjesë e rëndësishme e përvojave të mira në bujqësi.</p> <p>Kupton si duhet mbajtur shënime nga momenti i identifikimit, vjeljes, transportimit dhe përpunimit deri të paketimi dhe etiketimi i FM</p>	<p>Arrin të argumentoi origjinën e produktit dhe zonën ku është grumbulluar (gjurmëshmerinë).</p>		

Aplikon standardet dhe rregulloret për tharjen e FM.	<p>Mbanë evidencë gjatë procesit të tharjes dhe paketimit të materialit të grumbulluar</p> <p>Kupton rendësin që ka mbajtja e shënimeve gjatë tharjes që bëhet në tharëse artificiale.</p> <p>Kupton rendësin që ka marrja e shënimeve për datën e paketimit dhe llojin e materialit të përdorur për paketim.</p>	<p>Për çdo produkt shënon në libër temperaturat në të cilat është bërë tharja.</p> <p>Shënon orën e saktë të fillimit dhe përfundimit të tharjes.</p> <p>Kupton llojet e materialeve të lejuara për paketim.</p>	<p>realizim të detyrave me sukses.</p> <p>Posedon shkathtësi të manipuloi me tharëse.</p> <p>Ka shkathtësi të përzgjedhë materialet e lejuara për paketim.</p>	<p>Kryerja e kalkulimeve bazike matematikore.</p> <p>Shqisa të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjës dhe dëgjimit.</p>
---	---	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të realizuar këtë funksion nevojiten këto asete: parcela me fruta të malit, depo për ruajtjen e FM të vjelura, frigoriferi për ruajtje me ngrirje të thellë, tharëse artificiale, arkat ose thasë për transport të FM, mjetet transportuese, si dhe veglat dhe pajisjet manuale dhe mekanike të cilat përdoren gjatë mbledhjes dhe kultivimit, kalibrim, klasifikim dhe deponim të frutave.

Pos kësaj, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët për klasifikim, paketim dhe deponim të frutave; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

Kriteret e vlerësimit:

Për të arritur këtë funksion, kandidati duhet të jetë në gjendje të bëjë vjeljen sipas rregullave, të kuptojë procesin e pasvjeljes si dhe ruajtjen dhe higjienën personale dhe higjienën e vendin e punës.

Kandidati do të duhej t'i nënshtrohej një vlerësimi praktik. Kandidati mbikëqyret gjatë punës së tij/ saj sa i përket aktiviteteve në vijim: procesin e vjeljes, procesin e pasvjeljes apo përpunimin si dhe përgatitjen e depos sipas kushteve për ruajtje dhe higjienë. Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturave që kandidati i arrin në praktikim të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Evidenca e performances:

Evidenca do të bëhet përmes ushtrimeve praktike, demonstrimeve si dhe përmes listës së kontrollit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkuara më lart.

Funksioni 5: Njohet me kushtet agroekologjike të kultivimit të frutave të malit

Kjo ka të bëj me: Njohuritë e fituara për kërkesat e bimëve për kushtet agroekologjike siç janë: temperatura, lagështia, drita, lartësia mbidetare dhe toka.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
<p>Analizon dhe përcakton kushtet Agroekologjike</p>	<p>Kupton rendësin qe kane kushtet agroekologjike për kultivim të bimëve.</p> <p>Ka njohuri rreth kushteve agroekologjike për kultivim të FM</p> <p>Njohuri për temperaturat optimale për rritjen dhe zhvillimin e bimëve si dhe rëndësia e temperaturës për rritjen dhe zhvillimin e bimës.</p> <p>Njohuri për lagështi, dritë dhe lartësinë mbidetare optimale për rritjen dhe zhvillimin e bimëve.</p> <p>Njohuri mbi karakteristikat e tokës për kultivimin e bimëve të ndryshme</p>	<p>Ka njohuri të mira rreth kushteve agroekologjike qe kërkojnë llojet e ndryshme te bimëve siç janë temperaturat minimale, optimale dhe maksimale.</p> <p>Njohuri te mira rreth kërkesës e bimës për lagështi varësisht nga fazat e zhvillimit të bimës.</p> <p>Njohuri te mira rreth kërkesës se bimëve për dritë, tipit më të përshtatshme të tokave, lartësia mbidetare në të cilën mundë të kultivohen.</p> <p>Njohuri rreth pajisjeve që përdoren për matjen e faktorëve agroekologjik</p>	<p>Përdor dhe interpreton manualet rreth kërkesave të bimëve ndaj kushteve agroekologjike.</p> <p>Dine te përdorë pajisjet që bëjnë matjen e temperaturës, lagështinë dhe pH së tokës.</p>	<p>Bën zgjidhjen e problemeve në konsultë me kolegët.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale.</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen.</p> <p>I përshtatshëm për punë ekipore.</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur.</p>
<p>Përdorimi i pajisjeve moderne për matjen e parametrave ekologjik</p>	<p>Benë matjen e lagështisë në tokë me ndihmën e pajisjeve përkatëse.</p> <p>Bënë matjen e temperaturës me pajisje adekuate.</p> <p>Bënë matjen e lartësisë mbidetare me pajisje adekuate.</p>	<p>Njohuri te mira për shkallen e rrezikut te nitriteve, hormoneve dhe pesticideve te BA.</p>		<p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike matematikore</p> <p>Shqisa të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjës dhe dëgjimit</p>

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të realizuar këtë funksion nevojiten këto mjete të punës: tavolina e punës, kompjuteri, si dhe veglat dhe pajisjet manuale dhe mekanike të cilat përdoren për matjen e temperaturës, lagështisë dhe pH e tokës.

Pos kësaj, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët për përcaktimin e kushteve agroekologjike.

Kriteret e vlerësimit:

Për të arritur këtë funksion, kandidati duhet të jetë në gjendje të bëjë vlerësimin e saktë të kushteve agroekologjike. Kandidati/ja do të duhej t'i nënshtrohej një vlerësimi teorikë- praktik në punëtori.

Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturave që kandidati i arrin në praktik të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Evidenca e performances:

Evidenca do të bëhet përmes ushtrimeve praktike, demonstrimeve si dhe përmes listës së kontrollit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkruara më lart.

Funksioni 6: Kryen detyra agro-pomoteknike në kultivimin e frutave të malit

Kjo ka të bëj me: Me aktivitetet që ndërlidhen me kultivimin e frutave të malit në mënyrë ekstenzive dhe intenzive sipas sistemeve standarde të kultivimit. Ky funksion përfshinë edhe aktivitete tjera, varësisht nga lloji i frutave të malit si dhe natyrës së kultivimit

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
<p>Planifikon aktivitetet për ngritjen e plantacioneve me fruta të malit</p>	<p>Përzgjedhë parcelën për ngritjen e plantacioneve.</p> <p>dhe Përzgjedh llojet, varietetet dhe fidanët në përputhje me kushtet dhe qëllimet e prodhimit.</p> <p>Zbaton në terren Projektin për planin e pemishtes në përputhje me sistemin dhe me karakteristikat e parcelës së tokës.</p> <p>Zbaton në terren Planin për vendosjen e sistemit të ujitjes.</p> <p>Zbaton në terren sistemin e rekomanduar mbështetës sipas sistemit të kultivimit dhe llojit të bimës.</p>	<p>Njohjen e parcelave më të përshtatshme për kultivim.</p> <p>Njohjen e llojeve dhe karakteristikat të varieteteve.</p> <p>Njohuri të mira për sisteme të kultivimit.</p> <p>Njohjen e mënyrave më të përshtatshme për ujitje.</p> <p>Njohuri të mira në përgatitjen e tokës varësisht nga kërkesat e bimëve.</p> <p>Njeh dhe përdor plehrat organike dhe minerale.</p> <p>Ka njohuri rreth mënyrave të mbrojtjes së bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit.</p>	<p>Interpreton udhëzimet për përdorimin e veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Dinë të bëjë përdorimin e veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Ka njohuri për mënyrat e plehërimit të bimëve.</p> <p>Dinë të bëjë përdorimin e preparateve kimike.</p> <p>Përdor udhëzimet për procesin e prodhimit.</p>	<p>Bën zgjidhjen e problemeve në konsultë me kolegët.</p> <p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale.</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen;</p> <p>I përshtatshëm për punë ekipore.</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur.</p> <p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p>
<p>Bën përgatitjet e tokës dhe plehërimin sipas sistemit të kultivimit</p>	<p>Përgatitja e tokës sipas praktikave më të mira të kultivimit.</p> <p>Mbjell bimët sipas sistemit të planifikuar të kultivimit.</p> <p>Bën plehërimin e bimëve sipas kërkesave të bimëve për elemente ushqyese.</p>	<p>Ka njohuri rreth sistemeve të prodhimit si: prodhimi organik, prodhimi i integruar, prodhimi konvencional dhe prodhimi natyror.</p> <p>Merr njohuri për rrezikun e përdorimit të tepruar të nitriteve</p>		<p>Kryerja e kalkulimeve bazike matematikore</p> <p>Shqisa të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjës dhe dëgjimit</p>

Bënë mirëmbajtjen e plantacioneve sipas sistemit të kultivimit	Mbroytja e bimëve sipas sistemit të planifikuar të kultivimit. Bën ujitjen dhe riplehrimin me sistemet me adekuate të ujitjes. Bën mihjen, frezimin, herrjen, krasitjen dhe lidhjen e bimëve.	Merr njohur për demin që shkakton përdorimi i tepruar i pesticideve Njihet me demin që shkakton përdorimin i hormoneve në prodhimin e frutave		
---	---	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të kryer këtë funksion nevojitet parcela me fruta të malit. Duhet pasur në dispozicion vegla adekuate të punës (shati, lopata, gërshërë për krasitje. Rekomandohet të jenë në dispozicion edhe pajisje mekanike si traktori dhe pajisjet shtesë të traktorit (plugu, shpërndarës i plehut, spërkatës, pajisje për kositje). Pompa dhe mjet për ujitje. Nevojitet material bujqësor për të ushtruar këtë funksion si: plehra organike dhe inorganike pesticidet, ujë për ujitje, gypat për ujitje pik-pik, material për lidhje e të ngjashme.

Pajisje manuale ose mekanike për vjelje; pajisje transportuese duhet të jenë në dispozicion me rastin e vjeljes. Pos kësaj, duhet të ketë në dispozicion edhe materiale për paketim, etiketim si dhe vend për deponim të frutave të malit.

Pos kësaj, në përputhje me kushtet e punës duhet të jenë në dispozicion edhe: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet tjera mbrojtëse; manualët ose udhëzuesit për kultivim.

Vlerësimi do të bëhet në bazë të arriturve që kandidati i arrin në praktik të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Evidenca e performances:

Evidenca do të bëhet përmes ushtrimeve praktike, demonstrimeve si dhe përmes listës së kontrollit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkuara më lart.

Funksioni 7: Kryen detyra administrative dhe biznesore si dhe bën promovim e frutave të malit

Kjo ka të bëjë me: Me kryerjen e detyrave administrative dhe biznesore që janë të nevojshme për udhëheqjen e punës në një plantacion të vogël për kultivimin e dhe mbledhjen e frutave të malit. Funksioni përfshin kujdesin ndaj dokumenteve të punës, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogarive të thjeshta ekonomike; si dhe promovimin, tregtimin dhe shitjen e prodhimeve të vjelura, kultivuara dhe procesuara/përpunimit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të performuar funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
<p>Arrijnë të kryejnë detyra administrative dhe biznesore që kanë të bëjnë me FM</p>	<p>Mbanë shënime për aktivitetet që zhvillon gjatë procesit të kultivimit, vjeljes, përpunimit dhe magazinimit.</p> <p>Llogaritë koston e prodhimit dhe kujdeset për dokumentet për të siguruar llogari mbajtje të mirë dhe të saktë.</p> <p>Mban ditar në të cilin shënon çdo aktivitet që ndërmerret duke filluar nga mbjellja e fidanëve e deri të produkti final.</p> <p>Kryen shënime duke filluar nga lokaliteti i vjelur, qendra grumbulluese deri të eksportuesi.</p>	<p>Njohuri në përgatitjen dhe ruajtjen e dokumentacioneve të nevojshme të biznesit.</p> <p>Njohuri në mbajtjen e dosjeve.</p> <p>Kupton rendësinë e gjurmëshmërisë për llojet e vjelura/mbledhura në natyrë.</p> <p>Njohuri në përpilimin dhe mbajtjen e librave të blerjes dhe shitjes.</p> <p>Njohuri në përodrimin e pagesave përmes Bankës.</p> <p>Njohuri të mira për frutat e prodhuara.</p>	<p>Mban në mënyrë të rregullt dokumentet të biznesit.</p> <p>Ben kalkulime të thjeshta financiare.</p> <p>Shkathtësi të mira në përgatitje të dokumenteve që kanë të bëjnë me shitjen.</p> <p>Përdor pajisje teknologjike për komunikim kur ato janë në dispozicion.</p>	<p>Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale.</p> <p>I/e vetëdijshëm për punën që kryen.</p> <p>I përshtatshëm për punë ekipore.</p> <p>Kapacitete të analizon në mënyrë të pavarur.</p> <p>Respekton rregullat për siguri në punë.</p> <p>Kryen kalkulime bazike matematikore dhe biznesore.</p>
<p>Bënë promovimin dhe marketingun e FM.</p>	<p>Promovon në treg produktet e prodhuara duke filluar nga fidanët deri të materiali i paketuar për shitje.</p> <p>Përgatit materialet promovuese.</p> <p>Reklamon produkte të ndryshme nëpërmes kanaleve të ndryshme promovuese.</p> <p>Mbështet aktivitete të ndryshme promovuese në plantacion.</p>	<p>Njohuri të mira në përgatitjen e materialeve promovuese.</p> <p>Kupton rëndësinë e promovimit dhe bën promovimin e produktet e prodhuara.</p> <p>Organizon ditë fushore me qëllim promovimin si dhe tregtimin e produkteve</p>		

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës:

Për të qenë në gjendje të kryejë këtë funksion, kandidati/ja duhet të ketë në dispozicion burimet në vijim: tavolinë të punës; pajisjet për zyrë; shembuj dhe forma në letër ose në version elektronik të korrespondencës biznesore, si dhe pika të shtijës të mobiluara. Përpos burimeve të përmendura, për këtë funksion rekomandohet po ashtu të jenë në dispozicion kompjuteri me printer si dhe lidhje me internet.

Kriteret e vlerësimit:

Testet me shkrim si dhe pyetje – përgjigje, me qëllim të demonstrimit të njohurive dhe shkathtësive që kanë të bëjnë me aktivitetet kryesore. Vlerësimi do të duhej të përfshinte edhe llogaritjet. Kandidati do të duhej të vlerësohej për performancën e tij/ saj sa i përket aktiviteteve në vijim: krijimi i dokumenteve të biznesit, realizimi i shitjes, përgatitjen e logos, përgatitjen e një reklame të thjeshtë. Vlerësimi do të jetë i bazuar në krahasimin midis të arriturave të kandidatit dhe praktikës së sugjeruar.

Evidenca e performancës:

Instrumentet për vlerësim: Testi me shkrim si dhe listë kontrolli për vlerësimin e punës praktike.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, pyetjet dhe përgjigjet me gojë, për të treguar se kandidati ka kuptuar kërkesat e punës në lidhje me funksionet e përshkruara më lart.



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-323

Datë: 31.05.2019

Në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe neneve 4, 5, 6, të Udhëzimit Administrativ Nr: 28/2014 për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 21.05.2019 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit së bashku me të gjitha rekomandimet e ekipit të ekspertëve si standarde kombëtare të profesionit me këta emra dhe kode:
 - Dizajnerët dhe dekoratorët e interierit me kodin 3432 dhe me nivelin V të i kualifikimit sipas KKK
 - Marangozët dhe mobilierët/zdrukthëtarët me kodin 7115 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK
 - Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit me kodin 6115 dhe me nivelin III sipas KKK
 - Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore- aromatike me kodin 6116 dhe me nivelin III sipas KKK
2. Raportet e jashtme të verifikimit të standardit të profesionit duhet t'i dërgohet KAAPRr.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet;

KAAPRr
Arkivit të AKK



Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema